

**VENDIM**  
**Nr.200, datë 16.4.2004**

**PËR NJË SHITESË FONDI MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE TË  
TELEKOMUNIKACIONIT PËR PËRBALLIMIN E PAGESËS SË ASISTENCËS TEKNIKE  
PËR NJËSINË E MENAXHIMIT TË PROJEKTEVE TË TRANSPORTIT DHE  
DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË RRUGËVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit, në buxhetin e miratuar për vitin 2004, t’i shtohet fondi prej 46 800 000 (dyzet e gjashtë milionë e tetëqind mijë) lekësh, për përballimin e pagesës së asistencës teknike për Njësinë e Menaxhimit të Projekteve të Transportit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, për periudhën shkurt-shtator 2004.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohet Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**